



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

Anr.130/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Jeton Kocanëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.130/2021 të datës 10.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga “Rasim Këçina” në Komunën e Skenderajt, kundër Vendimit me Nr.0024 të datës 09.02.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinor, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “**largim nga shërbimi civil**”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 30.04.2021, me shumicë votave mori këtë

**V E N D I M**

- I. APROVOHET si e bazuar** ankesa më numër A.nr.130/2021 e datës 10.03.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr.0024/2021 i datës 09.02.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- III. OBLIGOHET** Ministri i Ministrisë së Financave, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës sipas Vendimit me Nr.Prot:2230/2019 të datës 05.02.2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e pagës nga dita e pezullimit nga detyra deri në zbatimin e këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Arsyetim

Ndaj ankuesit i emëruar sipas Vendimit me Nr. Prot:2230/2019 të datës 05.02.2019 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës në pozitën "Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës", Ministrija e Ministrisë së Financave, më datë 31.12.2020 ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit tek Kryesuesi i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë me arsyetim që ka bërë shkeljet si në vijim: *"Miratimin e Rregullores Nr. 13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura; Shpalljen e konkursit për tri pozita të Zëvendës-Drejtorëve të Përgjithshëm në kohën kur Ministria e Administratës Publike nuk ka lejuar që të zhvillohen procedurat e rekrutimit në shërbimin civil dhe lëvizja e shpeshita e stafit nga pozitat e tyre të punës pa ndonjë procedurë transparente dhe pa ndonjë konsultim me stafin duke shkaktuar pakënaqësi të madhe te stafi i ATK-së".*

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, më datë 11.01.2021 ka nxjerr Vendim me nr. 0007/2021 me të cilin ka bërë pezullimin nga detyra të ankuesit deri në një vendim tjetër, ndërsa më datë 27.01.2021 Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë ka dhënë sqarim lidhur me pezullimin nga detyra të ankuesit duke theksuar që z. [ ] i ndalohej çdo qasje në vendin e tij të punës dhe në asetet e ATK-së.

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë me datë 09.02.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 0024/2021 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "largim nga shërbimi civil".

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 0024/2021 të datës 09.02.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, më datë 10.03.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 1072/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave. Kryesuesi i Sekretariatit për Pozita të Larta Drejtuese, më datë 18.03.2021 ka dërguar përgjigjen në ankesë, ndërsa Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave ka theksuar që provat që posedon ministria janë të njëjta me ato që janë dërguar nga Sekretariati për Pozita të Larta Drejtuese.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, me qëllim të shqyrtimit të drejtë të lëndës, më datë 08.04.2021 ka ftuar në seancë publike ankuesin si palë ndërsa nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është ftuar ministri dhe Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore, mirëpo përveç ankuesit pala tjetër nuk ka marr pjesë duke njoftuar që *kjo çështje ka të bëjë me administratën e kaluar, ne si Ministri e Financave, Punës dhe Transfereve nuk do të marrim pjesë në seancë publike të datës 08.04.2021*. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, seancën e datës 08.04.2021 e ka shtyrë me datë 13.04.2021 me qëllim që të epët edhe një mundësi Ministrisë që ka iniciuar procedurën disiplinore që të marr pjesë në seancë, por MFTP nuk ka marr pjesë përsëri.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.04.2021 ka nxjerr Vendim VK.nr. 20/2021 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit edhe për 10 ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 10.03.2021 me numër protokollit 1072/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me nr. 0007 të datës 11.01.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë për pezullim nga detyra të ankuesit; E-mailin e datës 10.02.2021 nga për ankuesin; E-mailin e datës 09.02.2021 nga Vendimin me Nr. 0024 i datës 09.02.2021 nga Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë për largim nga shërbimi civil të ankuesit; Sqarim i datës 27.01.2021 nga Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; E-mailin e datës 27.01.2021 nga E-mailin e datës 27.01.2021 nga E-mailin e datës 27.01.2021 nga

Procesverbali Nr. 2 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë i datës 29.01.2020 për Vazhdimin e Seancës Dëgjimore; E-mailin e datës 26.01.2021, 31.01.2021, 29.01.2021 nga ankuesi për E-mailin e datës 29.01.2021 nga për ankuesin; E-mailin e datës 29.01.2021 nga ankuesi për Draft raport teknik janar 2020 nga Fondi Monetar Ndërkombëtar; Pjesë nga Raporti i progresit i BE-së; Pjesë nga Raporti i Bankës Botërore; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore kundër z. z datës 31.12.2020 nga Ministria e Ministrisë së Financave; E-mailin e datës 31.01.2020 nga ankuesi për etj; Shkresë përcjellëse lidhur me Projekt Rregullore mbi Organizimin e Brendshëm në Administratën Tatimore e datës 29.06.2016; Vendim mbi Strukturën Organizative të Administratës Tatimore të Kosovës i datës 15.03.2016; Rregullore MF/ATK Nr.2/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës; Projekt Rregullore Nr. ATK 13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës; e datës 17.05.2019; Struktura e Përgjithshëm Organizative e Administratës Tatimore datë 10.05.2019; Shkresë përcjellëse lidhur me Projekt Rregullore MF-ATK Nr.--/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës; e datës 10.05.2019; Vendimi mbi Strukturën Organizative të Administratës Tatimore të Kosovës i datës 10.05.2019; E-maili i datës 16.05.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 16.05.2019 nga për ankuesin; E-mailin e datës 24.06.2016 nga E-mailin e datës 04.04.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 01.04.2019 nga anusi; 01.04.2019 nga për ankuesin; E-mailin e datës 26.03.2019 dhe 25.03.2019 nga Rjolla Muja; E-mailin e datës 25.03.2019 nga E-mailin e datës 15.04.2019 nga ankuesi; Kundërshtim i njoftimin nga MAP i datës 10.09.2020; Rekomandimet e FMN ; Draft Raporti i Asistencës Teknike Nëntor 2017 nga Fondi Monetar Ndërkombëtar; Njoftim për ATK i datës 10.09.2019 nga Ministria e Administratës Publike; E-mailin e datës 10.12.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 30.12.2019 nga E-mailin e datës 30.12.2019 nga E-mailin e datës 27.12.2019 nga ankuesi; Komentet me stafin për strukturën organizative, përmes e-mailieve datë 07.05.2019; E-mailin e datës 23.01.2020 nga ankuesi; E-mailin e datës 23.01.2020 nga për ankuesin; E-mailin e datës 10.12.2019 nga Shkresë sqaruese lidhur me zhvillimet gjatë viti 2019 rreth ngritjes së Strukturës Organizative në ATK dhe sfidat gjatë zbatimit të saj datë 03.09.2020; E-mailin e datës 03.09.2020 nga ankuesi; Pëlqim i datës 12.05.2014; Konfirmim i FMN se Struktura Organizative është bërë në përputhje me Rekomandimet e FMN-së; Vendim i datës 13.06.2019; Vendim i datës 13.06.2019 për caktim në pozitën ushtrues detyre të zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Mbështetje të Programeve; Vendim i datës 13.06.2019 për caktim në pozitën ushtrues detyre të zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Programe dhe Procedura; Vendim i datës 13.06.2019 për caktim në pozitën ushtrues detyre të zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Operacione; Akt Emërimi i datës 28.02.2014; Akt Emërimin e datës 16.03.2016; Akt Emërimin e datës 23.02.2012; Njoftim për anulimin e konkursit i datës 19.06.2019; Kundër përgjigje ndaj pretendimet të Ministres së Financave për iniciim të Procedurës Disiplinor nga ankuesi për Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Vendimin me Nr. Prot:2230/2019 i datës 05.02.2019 i Kryeministrit të Kosovës; Ftese për

pjesëmarrje në seancë e datës 20.01.2021, 22.01.2021 dhe 27.01.2021 nga për ankuuesin; Procesverbal i Seancës Dëgjimore të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë i mbajtur më datë 22.01.2021; Shkresë njoftuese lidhur me suprimimin e pozitave të punës si rezultat i riorganizimit të Administratës Tatimore i datës 14.05.2014; E-mailin e datës 10.06.2019 nga E-mailin e datës 02.08.2019 nga Mendim Juridik i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në Cilësinë e Mikut të Gjykatës i datës 09.07.2020; Shkrim nga Kallxo.com i datës 12.09.2020; E-mailin e datës 16.09.2019, 17.09.2019 nga E-maili i datës 17.09.2019 nga E-mailin e datës 11.01.2019 nga Njoftim për pezullim të konkurseve datë 25.10.2019; Njoftim për pezullim të konkurseve të publikuara më datë 07.09.2019 nga Ministria e Financave; Njoftim i datës 08.10.2019 nga Ministria e Punëve të Brendshme; Konkurs i datës 22.03.2019 për Inspektor Tatimore (20 pozita); E-mail i datës 19.07.2017, 31.05.2019, 11.02.2019 nga E-mail i datës 29.10.2020 nga Ankesë e datës 07.08.2019 nga për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkurs i brendshëm i datës 05.06.2019; Vendim Nr. 126 i datës 18.06.2019 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i ATK-së; E-mailin e datës 07.05.2019 nga E-mailin e datës 08.10.2019, 29.10.2020, 10.06.2019, 06.08.2019, 30.07.2019 nga E-mailin e datës 08.10.2019, 25.02.2020 nga E-mailin e datës 10.07.2019 nga Vendimin e datës 16.03.2016 për emerimin e nga pozita zv. Drejtor i Drejtorit të Përgjithshëm për Operacione Për mbushëse në pozitën Zv. Drejtor i Drejtorit të Përgjithshëm për Programe dhe Procedura; Vendim Nr. 127 i datës 18.06.2019 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i ATK-së; Vendim i datës 13.06.2019 për caktimin në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Riskut; Vendimin e datës 13.06.2019 për caktimin e Udhëheqësit të Ekipit të mbledhjes së Detyrueshme në Drejtorinë Rajonale Prishtina 2; Vendim i datës 02.09.2019 për caktimin e ushtruesit të detyrës të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Operacione; E-mailin e datës 17.09.2019, 16.09.2019 nga Vendim i datës 13.06.2019 për caktimin e ushtrues së Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm për Operacione; Përgjigjen në ankesë e datës 19.03.2021; Ftesë për seancë publike e datës 01.04.2021 për ankuuesin, ministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Udhëheqësin e Divizionit të Burimeve Njerëzore; Flete kthesën e datës 01.04.2021; Procesverbal mbi seancën dëgjimore i datës 08.04.2021 dhe 13.04.2021; Njoftimin e datës 08.04.2021 nga Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për Këshillin për pjesëmarrje në seancë publike; Vendimin e datës 23.04.2021 për vazhdimin e afatit për vendosje dhe kërkesën për shtyrje të afatit të datës 22.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuuesit i cili pretendon se: vendimi me Nr.0024/2021 i datës 09.02.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të Qeverisë së Republikës së Kosovës është nxjerr jashtë afatit ligjor. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuuesit, ka analizuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë ka gjetur se Ministria e Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës, me datë 31.12.2020, përmes shkresës me numër protokolli 01-2367, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuuesit, ndërsa Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, me datë 09.02.2021 ka nxjerr Vendimin me numër 0024 përmes të cilit ankuuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil". Përkritazi me këtë konstatim, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, përkatësisht nenin 25 ku përcaktohet se: *Procedura disiplinore fillon, zhvillohet dhe përfundohet në pajtim me*

dispozitat e Rregullores përkatëse për disiplinën e zyrtarëve publik, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtareve Publik, përkatësisht nenin 12 paragrafi 6 ku përcaktohet se: **"Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore"**, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Vendimi numër 0024 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, nuk është nxjerr brenda afatit prej 30 ditësh, siç përcaktohet me dispozitat ligjore në fuqi, dhe si i tillë ky Vendim, në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **"një akt administrativ është i paligjshëm nëse; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative"**, andaj Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i 'u është referuar Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë, respektivisht nenit 5 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 i cili përcakton se: **"Aktet e pranuar dhe të ndara protokollohet në evidencën themelore, me numër të protokollit në të njëjtën ditë në të cilën janë pranuar, me përjashtim kur: 1.1. Aktet e caktuara për të cilat kërkohet përgjegje në afat të shkurtuar duhet protokolluar para akteve të tjera dhe menjëherë duhet dërguar njësive përkatëse për t'i pranuar. 1.2. Nëse për shkak të numrit të madh të akteve të pranuar ose për shkaqe të tjera të arsyeshme nuk mund të protokollohet në të njëjtën ditë kur janë pranuar, atëherë do të protokollohet më së voni ditën e ardhshme para se të pranohen aktet e reja"** dhe nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MAP) NR. 01/2017 për Administrimin e Punës në Zyrë, Evidencat Themelore dhe Detyrat e Punës së Arkivistit, mbi këtë bazë meqenëse nuk ka arsytim sipas dispozitave të lartcekura, atëherë protokollimi i vendimit të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë është protokolluar ditën e pranimit, me çka edhe më këtë dëshmohet se ky vendim është nxjerr jashtë afatit ligjore prej tridhjetë (30) ditësh.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në parimet e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 0024 të datës 09.02.2021, ka vepruar në kundërshtim edhe me ligjin material, sepse masën disiplinore ndaj ankuesi e ka shqiptuar mbi konstatimin se ankuesi në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, me veprimet e tij ka kryer shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ligj ky i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën për të cilën është shpallur përgjegjës ankuesi, prandaj ndërlidhur me Ligjin nr.005/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht neni 52 paragrafi 1.5 ku përcaktohet se një akt administrativ është i pa ligjshëm **"1.5 është në kundërshtim me ligjin material"**, prandaj në këtë kuptim edhe në këtë pikë vendimi nr.0024 është i pa ligjshëm, sepse Këshilli shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë ka shkelur parimin se ligji nuk mund të veproj në mënyrë **retroaktive**.

Kolegji ka konstatuar se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me datë 11.03.2019, ndërsa në dispozitat kalimtare të këtij ligji është parapare se i njëjti hynë në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, gjegjësisht 11.09.2019. Ligji për Zyrtarët Publikë ka qenë i aplikueshëm deri me datë 25.11.2019 kur është pezulluar me masë të përkohshme sipas Aktgjykimit me Nr.ref.:VMP 1472/19 të datës 25.11.2019 dhe Aktgjykimit me Nr.ref.:VVMP 1525/20 të datës 02.03.2020 të Gjykatës Kushtetuese. Pas vlerësimit të kushtetutshmërisë, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka hyre në fuqi me datë 09.07.2020, sipas Aktgjykimit me Nr.ref.:AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, konstaton se meqenëse Vendimi me Nr.0024/2021 i datës 09.02.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të Qeverisë së

Republikës së Kosovës është nxjerr në kundërshtim me afatet ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, atëherë sipas nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 dhe 1.5 Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është akt administrativ i paligjshëm, atëherë, shqyrtimi i pretendimeve tjera të ankuesit në rastin konkret është jo relevant.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”,* ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA ME NUMËR A NR.130/2021**

**Avdyl BEKTESHI**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**



Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Ministrisë të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.